



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 453, datë 24.07.2023**

**PËR  
MIRATIMIN E PENSIONIT TË PARAKOHSHËM DHE  
MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT PËR Z. {...},  
GJYQTARIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM DIBËR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 24.07.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e ardhur relatori z. Alban Toro për pranimin e kërkesës për dalje në pension të parakohshëm të gjyqtarit z. {...},

**V Ë R E N:**

**I. TË DHËNAT LIDHUR ME PROCEDURËN E NDJEKUR**

*1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 11.07.2023, është depozituar një kërkesë nga gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, z. {...}, me nr. 3893 prot, me objekt miratimin e pensionit të parakohshëm, referuar nenit 27 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (referuar në vijim si Ligji për Statusin). Si shkak të paraqitjes së kërkesës, magjistrati ka parashtruar **moshën e tij, mbi 60 vjeç dhe funksionin si gjyqtar.***

2. Nga informacioni i marrë në rrugë elektronike, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit rezulton se:

“-Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Shkenca Juridike dhe Politike, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 05.07.1989 (sistemi pa shkëputje nga puna).

-Me vendim nr. 2, datë 02.02.1991 të Këshillit Popullor të Rrethit Mat zgjidhet gjyqtar popullor në Gjykatën e Rrethit Mat.

-Me vendim nr. 246/B/4, datë 14.05.2009 të Këshillit të Lartë Gjyqësor pranohet pjesërisht kërkesa për procedim disiplinor dhe dërgohet për të ushtruar detyrën si gjyqtar për 1 vit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

-Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, datë 23.03.2022 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin e magjistratit (gjyqtar) pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

-Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 32 vite.

-Z.{...} nuk ka masa disiplinore në fuqi. .”.

3. Në rastin konkret, kërkesa e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, z. {...} bazohet në pikën 1, shkronja “a”, të nenit 27 të Ligjit për Statusin, i cili rregullon të drejtën përfitimit të pensionit të parakohshëm të magjistratit.

4. Në referim të pikës 3, të nenit 27 të Ligjit për Statusin, ku parashikohet se: **“Këshillat miratojnë pensionin e parakohshëm të magjistratit, pasi kanë marrë më parë mendimin e kryetarit të gjykatës/prokurorisë**, u kërkuar nga zv/kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, dhënia e mendimit lidhur me kërkesën e gjyqtarit z. {...} për dalje në pension të parakohshëm.

5. Lidhur me këtë kërkesë, me emailin e datës 12.07.2023, zv. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ndër të tjera parashitroi se: *“..omissis... Në përgjigje të email-it datë 12.07.2023, nëpërmjet të cilit kërkoni informacion lidhur me funksionalitetin e gjykatës, pas kërkesës së paraqitur nga Gjyqtari {...}, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për daljen në pension të parakohshëm, ju bëjmë me dije se: Referuar organikës së miratuar, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka në përbërje të saj 7(shtatë) gjyqtarë, nga të cilët aktualisht ushtrojnë funksionin 6(gjashtë) Gjyqtarë, të cilët gjykojnë të gjitha llojet e çështjeve, ndërsa 1(një) gjyqtar është transferuar përkohësisht pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Po ashtu, rezulton se gjyqtari {...}, aktualisht ka në gjykim 29 çështje gjyqësore, nga të cilat 13 civile e 15 penale. Nisur nga sa më sipër, në vlerësimin tim si Zv. Kryetare, çmoj se në kushtet aktuale, pranimi i kërkesës së Gjyqtarit {...}, për shkak të plotësimit të moshës për përfitim të pensionit të parakohshëm, nuk do të cenonte funksionalitetin e kësaj gjykate dhe gjykimi i çështjeve mund të vijohet me të njëjtën shpejtësi dhe cilësi sikundër edhe po vijon aktualisht. ...”.*

## II. PARASHIKIMET LIGJORE

6. Neni 27 i Ligjit për Statusin<sup>1</sup>, në momentin e paraqitjes së kërkesës nga z.{...} dhe aktualisht parashikon se:

**“1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse:**

- a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç;**
- b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit;**

.....

**1/2. Pensioni i parakohshëm është një pension pleqërie i reduktuar dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumën që del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 64 të këtij ligji, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë për magjistratët që plotësojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 1/1 të këtij neni është 0.6 % në muaj.**

.....

**3. Këshillat miratojnë pensionin e parakohshëm të magjistratit, pasi kanë marrë më parë mendimin e kryetarit të gjykatës/prokurorisë.**

**4. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, në të cilat përcaktohet:**

- a) procedura që ndiqet për kërkesat për pension të parakohshëm dhe dokumentacionin mbështetës;**
- b) rregullat për mënyrën e llogaritjes së pensionit të parakohshëm dhe përfitimeve të tjera, në rastet kur kërkesa pranohet”.**

7. Ndërsa, në nenin 64, pika 1 dhe 5, të ligjit, të titulluar “Kohëzgjatja në detyrë e magjistratit”, përcaktohen shprehimisht rastet e mbarimit të statusit të magjistratit. Konkretisht:

**“1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:**

- a) jep dorëheqjen;**
- b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;**
- c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji;**
- ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji;**
- d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.**

.....

**5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar**

---

<sup>1</sup> Ndryshuar me ligjin nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

*të qëndrojnë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaroi me vendim mbarimin e statusit të magistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës....”*

### **III. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË MAGJISTRATIT PËR PENSION TË PARAKOHSHËM**

8. Gjyqtari z. {...}, në kërkimin e tij, ka shprehur vullnetin për njohjen e së drejtës së përfitimit të pensionit të parakohshëm, bazuar në parashikimet e nenit 27, shkronja “a” e Ligjit për Statusin. Me tej, ai shtjellon se këtë kërkesë e mbështet edhe në “..omissis.... Unë gjyqtari {...}, duke shprehur vlerësimin tim maksimal për punën dhe kontributin tuaj në mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, parashitroj kërkesën time për dalje në pension të parakohshëm bazuar si me poshtë: Unë jam i datëlindjes 20.03.1959 dhe kam filluar punë si gjyqtar më datë 20.12.1990,

*detyrë të cilën e ushtroj pa ndërprerje dhe aktualisht jam gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Bazuar në parashikimet ligjore, plotësoj kushtet për daljen në pension të parakohshëm sepse kam 33 vjet gjyqtar dhe aktualisht jam 64 vjeç. Në këto kushte kërkoj të më pranohet kërkesa pasi plotësoj dhe të dy kushtet që përcakton ligji, konkretisht neni 27 i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ....etj.. Të dhënat e detajuara ndodhen në dosjen time personale të cilën Këshilli e disponon dhe e administron. Sa sipër mendoj se kërkesa ime është e bazuar në ligj dhe kërkoj të më pranohet.*

9. Duke interpretuar nenin 27, pika 1 të Ligjit për Statusin, në raport me parashikimet e legjislacionit për sigurimet shoqërore, konkretisht të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (referuar në vijim si Ligji 7703/1993), në përgjithësi, dhe në mënyrë të veçantë duke analizuar funksionin e kësaj skeme, si dhe provat e administruara, arrihet në përfundimin se, kërkesa e magistratit është e mbështetur në ligjet e sipërcituara dhe në aktet e administruara gjatë procedurës administrative. Fillimisht relatori çmon të analizojë kriteret e kërkuara nga ligji për përfitimin e pensionit të parakohshëm.

10. Si shprehje e solidaritetit njerëzor, termi "sigurime shoqërore" e ka origjinën e vet në politikën e mirëqenies të presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës Franklin D. Roosevelt gjatë viteve 1930 e me tej kur përcaktoi fillimin e programit për "sigurimin ndaj rreziqeve dhe peripecive të jetës" (Partsch, 1983: 14) duke e konkluduar më pas me "Aktin i Sigurimeve Shoqërore". Në vitin 1948 sigurimet shoqërore u shpallën zyrtarisht si e drejtë e njeriut në nenin 22 të Deklaratës së Përgjithshme të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe në vitin 2001, Organizata Ndërkombëtare e Punës “ILO” përkufizoi skemën e sigurimeve shoqërore si mbrojtja që një shoqëri ofron për individët dhe familjet në sigurimin e aksesit në kujdesin shëndetësor dhe për të garantuar sigurinë e të ardhurave,

sidomos në rastet e pleqërisë, papunësisë, sëmundjeve, invaliditetit, lëndimeve në punë, shtatzënieve ose humbjeve të mbajtësit të familjes.

10.1 Ky parim nuk do të thotë që të gjithë njerëzit në nevojë ose që kanë nevojë për mbështetje dhe mbrojtje do të përfitojnë nga sigurimet shoqërore. Sipas këtij parimi sistemi ju ofron mbrojtje të gjithëve pa dallim, por kur kanë plotësuar **kriteret e përcaktuara për përfitim ose mbrojtje** nga sigurimet shoqërore

11. Ligji 7703/1993 ka krijuar një sistem bazuar në parimin kontributiv të saj, solidaritetin dhe pjesëmarrjen, i detyrueshëm, publik, me mbulim universal, me kusht që ata/përfituesit të kenë kontribuar për një kohë të përcaktuar në skemë. Kjo e fundit krijon një lidhje të drejtpërdrejtë midis nivelit të kontributeve dhe përfitimeve të marra në momentin lindjes të së drejtës dhe përfaqëson një siguri, të garantuar me anë të solidaritetit shoqëror, që kur individi ka kontribuar vlerat e nevojshme në skemë, ai ka të drejtë të përfitojë një nga produktet e sigurimeve në përputhje me kriteret e përcaktuara në të. Ligji 7703/1993 kërkon në mënyrë të shprehur ekzistencën e të dyja kushteve, moshës dhe periudhës së kontributit/sigurimit, pra vjetërsisë në punë. Kështu, në pikën 1, të nenit 31 të këtij ligji, ku trajtohet pensioni i pleqërisë, parashikohet se: *“Personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92 të këtij ligji.”* Edhe pika 2 e këtij neni, që në dukje mund të konsiderohet se jep kuptimin e një pensioni të parakohshëm, ndonëse jo i konsideruar në mënyrë klasike qartësisht si i tillë, kërkon plotësimin e të dyja kushteve duke parashikuar se: *“Nënat që kanë lindur 6, a më shumë fëmijë, të cilët janë rritur më shumë se 8 vjeç, kanë të drejtën të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim.”*<sup>2</sup>

<sup>2</sup>Ne çështjen **BÉLÁNÉ NAGY v. HUNGARY** no. 53080/13) nder te tjera Gjykata e Drejtave te Njeriut ka arsyetuar se skema e pensionit për paaftësi shëndetësor operon bazuar ne dy kriteret kumulative :a) gjendja shëndetësore e individit dhe “kontributi” I cili kërkonte një periudhe te caktuar pune & 93 faqe 30; (“pension i parakohshëm” është parashikuar për herë të parë në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar (germa c, e nenit 73).

Ndërkohe qe e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të ushtarakëve i ka fillesat që me pensionin e parashikuar për ushtarakët në Ligjin nr.7496, datë 03.07.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Në nenin 16 të tij parashikohet se: “Oficerët dhe nënoficerët me vjetërsi shërbimi në ushtri 15 vjet për burrat dhe 12 për gratë, gëzojnë të drejtën e pensionit të pjesshëm në masën 50 për qind të pagës mujore. Për çdo vit tjetër shërbimi mbi kufirin e mësipërm jepet një shtesë pensioni në masën 2 për qind të pagës mujore. Kriteret e dhënies se pensionit përcaktohen me ligjin “Për sigurimet shoqërore”.”; neni 11 i Ligjit nr.8087/1996, të ndryshuar me Ligjin nr.8521/1999, që parashikoi kushtet dhe kriteret për caktimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Sipas këtij rregullimi ligjor ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm, që kanë dalë në rezervë dhe në lirim pas datës 03.07.1991, deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, do të përfitonin pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi kur plotësonin vjetërsinë e shërbimit si ushtarak, në masën 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat dhe të kishin mbushur moshën 42 vjeç për gratë dhe 47 vjeç për burrat; Më pas është miratuar Ligji nr.9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon ndër të tjera edhe të drejtën e ushtarakëve për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Ky ligj në nenin 35 parashikon të njëjtën skemë për përlllogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi si ligji i mëparshëm nr.8087/1996 i ndryshuar; Më pas u miratua Ligji nr.9418, datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i cili ndër të tjera në nenin 13 dhe 14 të tij parashikon kushtet dhe kriteret për përfitimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

11.1 Të njëjtën skeme kontributi ruajnë edhe sisteme te tjera sigurimi për kategori nëpunësit publik që operojnë në fusha te tjera, por edhe në disa vende Evropiane ku është parashikuar figura e pensionit të parakohshëm për gjyqtarët dhe prokurorët. Ky ligj ka përfshirë edhe standardet minimale të përcaktuara nga Konventa nr.102 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Për Sigurimet Shoqërore” .

11.2 Në nenin 1, të Ligjit 7703/1993 përcaktohet sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore i përberë nga:

- a) sigurimet shoqërore të detyrueshme;
  - b) sigurimi shoqëror vullnetar;
  - c) sigurimi shoqëror suplementar;
  - ç) pensionet shtetërore të posaçme;
  - d) pensionet sociale;
- dhe fondet profesionale dhe fondet e pensionit vullnetar.

12. Nga interpretimi i dispozitave ligjore të sipërcituar rezulton se skema e pensioneve përfshihet në skemën e sigurimeve shoqërore dhe është pjesë e saj mbështetur në të njëjtat kriteret dhe parime kontributive. Nenet 31 e në vijim të këtij ligji kanë parashikuar produktet e ndryshme të pensionit të parashikuar në këtë skemë, duke përcaktuar në mënyrë shteruese formulën, procedurën, kriteret dhe masën e kontributit për përfitimin e saj.

13. Në zbatim të së drejtës Kushtetuese, të parashikuar nga neni 51 pika 1<sup>3</sup> dhe Ligjit 7703/1993, gëzimi i pensionit të pleqërisë përcaktohet si e drejta e çdo personi për të përfituar pension pleqërie me arritjen e një moshe të caktuar sipas parashikimeve të posaçme në ligj. Në këtë kontekst, legjislacioni për statusin e magjistratit ka parashikuar mbarimin e statusit të magjistratit në fund të muajit, në të cilën magjistrati mbush moshën 67 vjeç, duke i dhënë mundësinë atij të qëndrojë në detyrë, pavarësisht mbushjes së moshës për të përfituar pensionin e pleqërisë sipas skemës së sigurimeve të detyrueshme shoqërore. Si një nga format

---

*Edhe sipas këtij ligji skema për llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi është e njëjtë me atë të parashikuar nga ligjet e mëparshme në fushën e sigurime shoqërore suplementare të ushtarakëve (Ligji nr.8087/1996, i ndryshuar) por me ndryshim sa i takon kufizimit të masës së këtij pensioni; Ligjin nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj në nenin 14 paragrafi i parë i tij parashikon të njëjtën skemë për llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi me atë të parashikuar nga ligjet e mëparshme në fushën e sigurime shoqërore suplementare të ushtarakëve (Ligji nr.8087/1996, i ndryshuar dhe Ligji nr.9418/2005 i ndryshuar) por me ndryshim sa i takon kufizimit të masës së këtij pensioni; . 2- Italia moshë 60 vjeç me 36 vjet kontribute; Austria moshë 62 vjeç me 480 muaj kontribute; Polonia për gratë moshë 55 vjeç kur provojnë se kanë ushtruar funksionin 25 vjet, për burrat 60 vjeç me kontribut 30 vjet; Rumania gjyqtari mund të dale në pension pasi ka ushtruar funksionin për 25 vjet; etj.; 2. Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paafte për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj.*

<sup>3</sup> Neni 52, pika 1 e Kushtetutës - Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paafte për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj.

përrjashtuese të kufirit maksimal moshor për të ushtruar statusin e magjistratit dhe e parashikuar si e drejtë e tij, ligji ka përcaktuar edhe pensionin e parakohshëm.

14. Pensioni i parakohshëm i pleqërisë, parashikuar nga neni 27 shkronja “a” e Ligjit për Statusin përfaqëson “*Institucion atipik pensioni pleqërie*”. Ky Institucion përfshihet në sistemin e garancive të parashikuara nga neni 138 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ka si qëllim të përmirësojë sistemin e kujdesit social për magjistratët në mënyrë që të garantohen përfitime financiare në përputhje me dinjitetin e detyrës së magjistratit edhe në rastet kur nuk janë plotësuar kushtet për pensionin e plotë të pleqërisë. Në këtë nen përcaktohet, ndër të tjera, se: “*Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse:*

*a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç;*

*b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit; ...omissis..”*

15. Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se ligjvënësi ka synuar të rregullojë të drejtën e magjistratit për të përfituar pension të parakohshëm pleqërie, duke e lidhur **me plotësimin e kushteve dhe kritereve shteruese dhe që janë në përputhje me parimet ku mbështetet skema e pensioneve të rregulluara nga Ligji 7703/1993**. Përfitues të saj rezulton të jenë vetëm ato magjistratë që kanë mbushur moshën 60 vjeç, kanë ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vite, si dhe ata që për shkak të sëmundjes, nuk janë më në gjendje për të ushtruar funksionin.

16. Parimi i qëndrueshmërisë në detyrë (palëvizshmëria) kërkon që gjyqtarët të garantohen të qëndrojnë në detyrë për të ushtruar funksionin deri në momentin/moshën e parashikuar nga ligji për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Ky parim ka vetëm një përjashtim kur për shkaqe të justifikuara dhe të lidhur me motive të ligjshme, gjyqtari me dëshirën e tij kërkon të përfitojë pensionin e parakohshëm.

17. Nga aktet e administruara rezulton se z. {...} ka paraqitur një kërkesë me shkrim për përfitimin e pensionit të parakohshëm të pleqërisë.

18. Kërkimi i gjyqtarit se për shkak të arritjes së moshës minimale të kërkuar (60 vjeç) dhe kontributi 30 vjeçar si magjistrat, përfaqësojnë kritere për të përfituar pensionin e parakohshëm të pleqërisë është i bazuar në ligj dhe në parimet që përshkojnë institutin e sigurimeve shoqërore. Që sistemi i sigurimeve shoqërore të funksionojë, duhet që pjesëmarrësit e tij të paguajnë kontributet e përcaktuara në ligj dhe ai të financohet apo subvencionohet nga buxheti i shtetit. Pagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore është burimi kryesor i financimit të sigurimeve shoqërore dhe mospagim i tyre do të vinte në vështirësi sistemin, rritjen e subvencionit nga buxheti i shtetit dhe humbjen e qëllimit të krijimit të vetë sistemit, që është financimi i përfitimeve që merr individi nga sigurimet shoqërore, nga vetë ai nëpërmjet kontributit mujor.

19. Për këtë qëllim ligji kërkon kumulativitetin e kriterëve të përcaktuara në këtë dispozitë, (nenit 27, pika 1 të Ligjit për Statusin), me qëllim që magjistrati të përfitojë nga e drejta për t'ju trajtuar me pension të parakohshëm pleqërie, pasi ajo përsëri përfshihet dhe mbetet në një skemë kontributive madje edhe ndryshimet e kryera së fundmi theksojnë më shumë parimin kontributiv të saj. Fakti që ligjvënësi shfuqizoi shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 27, ku parashikohej si kriter kumulativ, bashkë me moshën dhe periudhën e ushtrimit të funksionit, edhe pamundësia e magjistratit për të ushtruar funksionin, për shkak të sëmundjes, tregon atë rëndësi që kishte bërë për magjistratët, pra duke i vendosur edhe një kusht shtesë, ndryshe nga të gjithë punonjësit e tjerë. Me ligjin nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky kriter është shfuqizuar dhe përfitimi i pensionit të parakohshëm, në rastet e sëmundjeve, tashmë është trajtuar si një rast i veçantë, i lidhur me nenin 67 të Ligjit për Statusin, por periudha e kontributit, (30 vjet/periudha e domosdoshme e sigurimit), dhe mosha, (60 vjeç), vazhdojnë të mbeten kriterë kumulative. Një trajtim i ngjashëm është parashikuar edhe nga legjislacione që trajtojnë kategori të ndryshme të funksionareve publike për të cilët Autoriteti Publik ka treguar interes në përmirësimin e sistemit të kujdesit social, (“pension i parakohshëm” e parashikuar për herë të parë në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar (shkronja c, e nenit 73).

20. Nga sa me sipër rezulton se kërkuesi i plotëson të dy kriteret e përcaktuara nga ligji, mosha, të paktën 60 vjeç dhe ushtrimi i funksionit të magjistratit për të paktën 30 vjet, për përfitimin nga skema e sigurimeve shoqërore të pensionit të parakohshëm. Në kushte të tilla kërkesa e magjistratit është një kërkesë e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

21. Në kushtet kur magjistratit ka kërkuar pensionin e parakohshëm dhe nga provat e administruara rezulton se ai i përmbush kriteret e kërkuar nga ligji për përfitimin e saj, nga ana e Këshillit u çmua të shprehet edhe për mbarimin e statusit të magjistratit si pasojë *sine qua non* e përfitimit të këtij pensioni.

21.1 Në kuptim të nenit 64 pika 1, shkronja “c” e Ligjit për Statusin, statusi i magjistratit përfundon kur “..omissis...mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji”. Më lart kemi arsyetuar se ligji i sipërcituar në nenin 27 të tij ka parashikuar pensionin e parakohshëm si pjesë të kategorisë të pensionit të pleqërisë së magjistratit, me ndryshimin se për përfitimin e saj do të duhej mbushja e moshës 60 vjeç, si kufirin minimal si edhe kontributi tridhjetë vjeçar si magjistrat.

21.2 Bazuar në interpretimin literal dhe sistematik të normës, vlerësohet se ligjvënësi përmes përdorimit të shprehjes “sipas parashikimit të këtij ligji” e ka lidhur daljen në pension të magjistratit me plotësimin e kushteve dhe kriterëve që parashikon kuadri ligjor i posaçëm, parë kjo edhe në kontekstin e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës. Në kushtet kur në kuptim të nenit 27 pika 1/2 pensioni i parakohshëm është një pension pleqërie i



reduktuar, i cili gëzohet nga magjistrati kur plotësohen kriteret e këtij ligji atëherë në rast të përfitimit të tij dhe pranimit të kërkesës së magjistratit nga Këshilli, detyrimisht një fakti i tillë shkakton mbarimin e statusit të magjistratit.

21.3 Dhënia e dorëheqjes apo dalja në pension të parakohshëm e magjistratit, përbëjnë rastet e mbarimit të vullnetshëm të statusit të magjistratit. Në këtë mënyrë, magjistrati nëpërmjet kërkesave respektive shpreh vullnetin e tij për të mos qëndruar në detyrë dhe për të mos e ushtruar atë, dhe si rrjedhojë për të mos gëzuar statusin e magjistratit deri në mbushjen e moshës maksimale 67 vjeç, moshe e cila përcaktohet në Ligjin e Posaçëm si moshë e daljes në pension të plotë pleqërie. Kjo logjikë e interpretimit të dispozitës del në pah dhe në parashikimet e nenit 27, pika 1/2 të ligjit sipas të cilit *pensionit i parakohshëm mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë.*

#### **IV. KONKLUZIONE**

Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi dhe situatën faktike të parashtruar, vlerësohet se magjistrati, gjyqtari z. {...}, i përmbush kushtet që kërkon ligji për përfitimin e pensionit të parakohshëm. Nisur nga kjo, Këshilli çmohet se është vendi për pranimin e kërkesës për dalje në pension të parakohshëm të gjyqtarit z. {...}.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “ë” dhe 97, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenet 27, pikat 1 e 1/2 dhe 64, pika 1, shkronja “c”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi kërkesën e magjistratit z. {...} për daljen në pension të parakohshëm, me propozim të relatorit z. Alban Toro,

#### **VENDOSI:**

1. Pranimin e kërkesës.
2. Miratimin e pensionit të parakohshëm për magjistratin z. {...}.
3. Pensioni i parakohshëm për magjistratin z. {...} llogaritet dhe paguhet nga organet e sigurimeve shoqërore sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 1/2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Mbarimin e statusit të magjistratit z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për shkak të daljes në pension të parakohshëm pleqërie.

5. Efektet juridike të urdhërimeve sipas pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, fillojnë më datë 15.09.2023.
6. Përfundimin e menjëhershëm të gjyqtarit z. {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
7. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistratit, gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**Kryetare**  
**NAUREDA LLAGAMI**

**Zëvendëskryetar**  
**ILIR RUSI**

**Anëtar**  
**KLODIAN KURUSHI**

**Anëtare**  
**BRIKENA UKPERAJ**

**Anëtare**  
**FATMIRA LULI**

**Anëtare**  
**IRENA PLAKU**

**Anëtare**  
**MARÇELA SHEHU**

**Anëtare**  
**YLLKA RUPA**

**Anëtar**  
**RIDVAN HADO**

**Anëtar**  
**ALBAN TORO**

**Anëtar**  
**DRITAN HALLUNAJ**